



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përhershme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturale, Peizazh kulturor

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Hamami i Gazi Mehmed Pashës

(Fotografi pamje karakteristike, dt...)



Pamje jugore e hamamit para restaurimit_ 2012

Datimi/et (Relativ/e) : 1563 – 1574 (Shek XVI)

Periudha/t historike: Periudha Osmane

Adresa: Vendndodhja, Qyteti/Fshati, Komuna

Rr: “Adem Jashari”, lagjja: Saraçhane, 20000, Prizren

Lloji i asetit të propozuar

(Kategoria ligjore dhe Nënkatëgoria sipas nenit 2 të LTK)

Kategoria: Trashëgimia Arkitekturale;

Nënkatëgoria: Monument / Ansambël

Numri unik : 000437

Numri i regjistrit në KKTK:

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/referenca e dokumentit/aktit nëse ka
(Akti i mëhershëm nëse ka)

Vendim Nr. 380/54, më datë: 18.09.1954

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

(Të përshkruhet arsyetimi se përse aset i propozuar konsiderohet i rëndësishëm dhe duhet të vendoset në mbrojtje të përhershme.)

Hamami i Prizrenit përmban vlera të rëndësishme arkitekturale, historike dhe kulturore për qytetin dhe regjionin. Si një monument nga periudha e hershme Osmane, ai është njëri prej hamameve më të rëndësishme në Evropën Jug-lindore.

Hamami është i veçantë në aspektin arkitektural dhe kulturor ku janë ngërthyer traditat arkitekturale vendore me ato orientale duke i dhënë ndërtesës një pamje të veçantë dhe autoktone karakteristike për këto treva. Në aspektin kulturor hamami dëshmon për rëndësinë e madhe që i është kushtuar pastërtisë dhe mirëmbajtjes së higjienës personale dhe kolektive në mesjetë fakt ky që mungonte në shumë vende të Evropës. Po ashtu hamami ka pasur ndikim direkt dhe indirekt në emancipimin dhe mirëqenien e shoqërisë ngase mbulonte shpenzimet e institucioneve arsimore, sociale, shëndetësore, etj.

I ndërtuar në qendër të qytetit, hamami për shekuj me radhë ka qenë pjesë e pandashme e jetës së qytetarëve të Prizrenit dhe është shndërruar në simbol shpirtëror dhe kulturore për qytetin dhe regjionin.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aset

(Specifikimi/përshkrimi i kriterëve sipas Nenit 4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS)

Vlerat historike: Hamami i Gazi Mehmed Pashës me vjetërsinë dhe origjinalitetin e ruajtur deri në ditët e sotme, paraqet një dëshmi të zhvillimeve kulturore dhe arkitekturore gjatë shekullit XVI dhe XIX në Prizren. Po ashtu është dëshmi e mënyrës së re të jetesës dhe organizimit shoqëror krahas periudhës pararendëse (para Osmane). Edhe ndërtuesi i hamamit Gazi Mehmed Pasha ka qenë një personalitet i rëndësishëm që ka lënë gjurmë të rëndësishme në këto treva në mesin e shekullit XVI. Gazi Mehmed Pasha përpos pjesëmarrjes në betejat të ndryshme ka ndërtuar objekte të ndryshme si *vakëf* – bamirësi anembanë perandorisë Osmane.

Vlerat artistike: Hamami i Prizrenit është njëra prej ndërtesave publike më të dalluara që datojnë nga periudha Osmane. Posedon vlera estetike që përfshin kombinimin e volumeve në eksterier, teknikat e ndërtimit dhe elemente origjinale të ruajtura në enterier. Vlerat e lartpërmendura e shndërrojnë hamamin në njërin prej pikave kryesore të referimit në peizazhin kulturor dhe vizual të Prizrenit.

Vlerat shkencore: Hamami paraqet një dëshmi faktike për të zhvilluar studime shkencore rreth sistemit të ndërtimit dhe stabilitetit të strukturës ndaj tërmeteve; Një rast studimi për sistemin ujësjellës dhe të kanalizimit gjatë shek. 16; Studim për sistemimin dhe shpërndarjen e ujit të ftohtë dhe të nxehtë në pika të ndryshme të hamamit me rënie të lirë; Studim për materialet ndërtimore të qëndrueshme ndaj ndikimeve të ujit dhe motit; Studim për efikasitetin termik brenda ndërtesës, mënyra e ngrohjes së ujit dhe ambienteve të hamamit në masë të caktuar sipas nevojës.

Krahas hulumtimeve teknike shkencore, vetë ndërtesa paraqet një dëshmi për studime dhe hulumtime në fushën e arkeologjisë, kulturës, arkitekturës dhe sociologjisë.

Vlerat shoqërore: Krahas vlerave historike, teknike dhe estetike, Hamami ka vlerë të madhe shoqërore. Ai përfaqëson vendin ku është mirëmbajtur higjiena personale. Hamami ka qenë gjenerues material dhe ishte si "donator" i institucioneve jo profitabile e sidomos kompleksit të Mehmed Pashës. Krahas funksionit shërbyes, Hamami ka qenë një vend takim për njerëzit. Edhe pse tani ka humbur funksionin origjinal, Hamami vazhdon të jetë një vend takim dhe pikë referuese për komunitetin lokal të Prizrenit.

Vlerat shpirtërore: Hamami është simbol i identitetit kulturor dhe fetar; paraqet njërin nga simbolet e identitetit Osman të ndërlidhur me identitetin lokal të Prizreni gjatë shek. 16. Kultura e larjes në hamame ishte bërë pjesë e jetesës së popullatës së Prizrenit dhe më gjerë. Konsiderohet si njëri prej monumenteve kryesore që e identifikojnë qytetin.

Rariteti: Hamami i Gazi Mehmed Pashës është njëra nga gjashtë hamamet e Kosovës respektivisht njëra nga katër hamamet dysh (çifte hamam). Për nga madhësia dhe origjinaliteti është i vetmi i ruajtur në Kosovë dhe njëra nga 3-4 hamamet e rajonit.

Propozuesi:

Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren – MKRS

Emri/Mbiemri: Samir Hoxha

Nënshkrimi _____

Adresa dhe kontakti: Adresa: Rruga "Marin Barleti" nr. 11, 20 000 Prizren

Tel: 029/244-487

Mob. +37744/216-010

Email: samirhoxha11@gmail.com

samir.hoxha@rks-gov.net

Data :/..../.....

Bashkëngjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt..../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

(Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit)

Komuna e Prizrenit, Prizren, Rr. "Adem Jashari", 20000

Qyteti i Prizrenit shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit, në rrugën që lidhte më parë bregdetin verior të tokave shqiptare dhe qendrat e tij qytetëro- tregtare me rajonet e brendshme të Kosovës dhe të Ballkanit.

Prizreni është i njohur që nga antikiteti si një vend unik në Ballkan për vlerat e trashëgimisë kulturore, të civilizimeve dhe religjioneve të ndryshme. Falë pozitës së favorshme gjeografike, gërshetimit harmonik të kulturave gjatë historisë dhe një numri të lakmueshëm të monumenteve të trashëgimisë kulturore të të gjitha kohërave, qyteti i Prizrenit me plot të drejtë mban epitetin e "qytetit muze" apo "muzeut nën qiellin e hapur", dhe radhitet si njëra ndër qytetet më të bukura të Kosovës.

Nga e kaluara, qyteti i Prizrenit ka trashëguar një numër të madh objektesh kulturo -historike. Më të rëndësishme janë : Kompleksi i Shatërvanit, Nënkalaja, Marashi, Kalaja, Kisha e Shën Premtes, Kisha e Shën Shpëtimit, Xhamia e Bajraklisë, Xhamia e Sinan Pashës, Hamamet, krojet publike, ura e gurit dhe një numër i madh i shtëpive tradicionale të trashëguar ndër shekuj.¹

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda (KosovaNeëRef I)

Lat: 7478649; Lon: 4674637

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Hamami është i vendosur në Qendrën Historike të Prizrenit, respektivisht në nën-zonën Zona e aksit të dyqaneve. Hamami ka qenë ndërtesë publike kryesore e pazarit (lagjes) të Saraçhanes ku ushtrohej zeja e punimit të pajisjeve për kuaj dhe qerre dhe Tereke pazarit, ku organizohej tregu i drithit, i rrethuar me lokale tradicionale, ku kalonte edhe përroi. Është pjesë e kompleksit të Gazi Mehmed Pashës i cili përmban një xhami, tyrben dhe medresen (shkollën), derisa për 34 dyqanet e lëna po ashtu si vakëf nuk dihet saktë pozita e tyre. Pranë Hamamit gjenden edhe monumente tjera me rëndësi, sikurse Xhamia e Emin Pashës, minarja e xhamisë Arasta (Jakub Evrenoz Beut), xhamia e Saraçhanes (Kuli Mehmed Beut), teqja e tarikatis Halveti dhe disa shtëpi tradicionale që datojnë nga shek. 18 dhe 19.

Parcela e hamamit nga tre anë kufizohet me rrugë, ndërsa në anën perëndimore kufizohet me ndërtesa banimi.

Qendra Historike e Prizrenit është e klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar. Mbrojtja, administrimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i kësaj qendre rregullohet nëpërmjet ligjit Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit. Kjo Zonë, ku

¹ Ueb faqja zyrtare e Databazës së trashëgimisë Kulturore të Kosovës, http://dtk.rks-gov.net/tkk_trashegimia.aspx?qyteti=20

gjendet edhe Hamami i Gazi Mehmed Pashës është e përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore në kategorinë: Trashëgimia Arkitekturale, dhe nënkategorinë: Fushë e konservimit arkitekturor. Qendra Historike e Prizrenit njëherit paraqet edhe zonën rrethuese mbrojtëse të Hamamit të Gazi Mehmed Pashës dhe aseteve tjera të trashëgimisë kulturore, të cilët gjenden brenda sipërfaqes së kësaj zone.

Perimetri i asetit të propozuar: _____ ha

Zona rrethuese për mbrojtje/Buffer zone: _____ ha

Sipërfaqja totale: _____ ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- Planet e situacionit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese $P=1:500$ dhe $1:200$ (nëse është e aplikueshme).
- Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje.
- Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min. tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projeksioni, emri i pronarit dhe data.
- Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratigrafinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

- Përshkrimi i asetit të propozuar nga momenti i propozimit, duke specifikuar përmbajtjen e të gjitha elementeve dhe karakteristikat domethënëse të tyre ndërlidhur me atributet e trashëgimisë kulturore.
- Në rastin e trashëgimisë arkitekturore (monument, ansambël/tërësi dhe fushë e konservimit arkitekturor) dhe të trashëgimisë arkeologjike (monument, ansambël, lokalitet apo rezervat) të bëhet përshkrimi i të gjitha elementeve ndërlidhëse të asetit në kuptimin e veçorive të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër përfshihet përshkrimi i ndërtesës, strukturës ose ndërtesave/strukturave, planimetritë, sistemi i ndërtimit, stili arkitekturor, proporcionet, ritmi, enterieri, materialet, datimi dhe aspektet tjera ndërlidhëse të lokacionit të asetit, siç janë: terreni, oborri, mobiliat, pikturat, ikonat, mbishkrimet epigrafike, mjedisi rreth tij, etj.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është një monument i periudhës së hershme Osmane ku janë të kombinuar traditat orientale të ndërtimit me ato lokale. Gjendet në qendër të qytetit pranë Xhamisë së Kukli-Mehmed Beut dhe Xhamisë së Emin Pashës. Është ndërtuar në vitin 1563-74, nga Gazi Mehmet Pasha - Sanxhakbej i Shkodrës gjatë viteve 1573-4. Në portën kryesore është vendosur pllaka me mbishkrim (viti 1833) e cila tregon datën e restaurimit të hamamit nga ana e vëllezërve Mahmud dhe Emin Pashë Rrotulli (djemtë e Tahir Pashë Rrotullit – mytesarif i Prizrenit).

Hamami gjendet në kuadër të ansamblit arkitektonik të themeluar nga Gazi Mehmet Pasha, ku gjenden Xhamia e Bajraklisë, shkolla e mesme (medrese), shkolla fillore (mejtëpi), biblioteka

dhe mauzoleumi (*tyrbja*), derisa për 34 dyqanet e lëna po ashtu si *vakëf* nuk dihet saktë pozita e tyre.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është hamam çift, që nënkupton se posedon hapësira të ndara për shfrytëzim nga meshkujt dhe femrat në të njëjtën kohë. Karakterizohet me strukturën e 20 kupolave; dy më të mëdha janë mbuluar me qeramidhe, kurse kupolat tjera më të vogla dhe qemerët kanë qenë të mbuluar me pllaka të plumbit. Gjatë viteve disa herë është ndërruar mbulesa e hamamit, kështu një kohë ajo ka qenë e mbuluar me pllaka të rrafshëta të argjilës, pmë pas me rrasa guri, me llaç gëlqeror dhe çimento, etj. Pas viteve 1960 kur fillojnë punimet për restaurimin dhe revitalizimin e hamamit me qëllim të shndërrimit në muze ose galeri, pullazi mbulohet sërish me pllaka të plumbit. Enterieri përbëhet nga ambientet të shumta të vendosura njëra pas tjetrës me destinim të veçantë për secilin.

Hamami ka të gjitha hapësirat që kanë hamamet e këtij lloji (*çifte hamam*), dhe përbëhet prej pjesës hyrëse - gardërobës (pjesa për pritje si dhe për pije), pjesës ndërlidhëse (parapërgatitja për larje dhe nyjet sanitare, pjesës qendrore ku bëhej larja, djersitja, dëfrimi si dhe pjesës së kaldajës që gjendet në pjesën jugore të objektit.

Planimetria - Bërthama arkitektonike e Hamamit përbëhet nga:

Zona e ftohtë – *apodyterium*: Kthina (Ambienti i) e gardërobës me një fontanë në mes vetëm në pjesën për meshkuj;

Zona e vaktë – *tepidarium*: Kthinat për rruaje dhe depilim;
Kthinat e tualeteve;
Kthina për adaptimin e trupit dhe furnizimi me rekuizita;

Zona e nxehtë – *caldarium*: Kthinat për larje dhe djersitje;
Hapësira për masazh;

Zona teknike-qylhani - *praefurniumi*: Depoja e ujit;
Oxhaku.

Hamami është ndërtuar kryesisht me gur lumor dhe pjesërisht me tulla të lidhur me llaç gëlqeror. Muret kanë një trashësi rreth 90cm, të suvatuara nga ana e brendshme me llaç horosan. Pullazi i objektit përbëhet prej dy kupolave (kubëve) të mëdha të ngritura mbi tambure në pjesën e ftohtë (pritja-garderoba) të hamamit, nëntë kupolave (kubëve) të vogla dhe gjashtë qemerëve mbi pjesën e ngrohtë, ndërsa pjesa e gardërobës është mbuluar me dy qemerë dhe ambienti i depos së ujit (kaldatores) me një qemerë. Mbulesa e pullazit është me tjegulla në pjesën e ftohtë, ndërsa me pllaka të plumbit në pjesët tjera të hamamit.

Deri në vitet 1964 Hamami ka qenë i rrethuar me lokale me ç'rast bëhet rrënimi i tyre në emër të rregullimit urbanistik të qytetit dhe njëherit hapet rruga për vazhdimin e punëve restauruese-konservuese. Edhe në vitet pasuese bëhen disa renovime të kohë pas kohshme deri në vitet 90 të shek. XX kur hamami lihet në mëshirë të kohës.

Prej vitit 2000 pjesa e ftohtë e Hamamit shfrytëzohet si galeri për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike dhe edukative.

Hamami paraqet njërën prej ndërtesave publike më karakteristike të periudhës Osmane në Prizren, me rëndësi të jashtëzakonshme historike, arkitektonike, shoqërore dhe mjedisore.

Shtojcë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës

Funksioni aktual: Hamami është në proces të konservimit dhe aktualisht nuk shfrytëzohet.

Pronësia: Hamami i Gazi Mehmed Pashës është pronë e Bashkësisë Islame (fl. posed. *Vakuf Mehmed Pasha*). Kjo ndërtesë menaxhohet nga Qendra Regjionale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, si institucion përgjegjës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në regjion të Prizrenit. Nuk ekziston ndonjë dokument i shkruar që rregullon çështjen e të drejtës së menaxhimit të Hamamit nga QRTK Prizren.

Shfrytëzuesit aktual: Deri në shtator të vitit 2013, kur kanë filluar ndërhyrjet konservuese, organizata të shumta, artistë dhe shkrimtarë e shfrytëzojnë herë pas here hapësirat e Hamamit për të organizuar aktivitete kulturore, shoqërore dhe artistike.

Zhvillimi historik dhe kronologjik i asetit

- Përshkrimi i formësimit të asetit nga themelimi deri në gjendjen aktuale, duke specifikuar ndryshimet, transformimet, demolimet apo rindërtimet domethënëse në historinë e konservimit.
- Ndërlidhur me asetet e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike, të bëhet paraqitja e fazave kryesore ndërtimore për: monumente, ansamble, fusha të konservimit arkitektural, lokalitete dhe rezervate. Peizazhi kulturor, të përshkruhet sipas të dhënave të lartëshënuara, duke përfshirë aspektin e historisë dhe kronologjisë së aktiviteteve njerëzore në mjedisin natyror.

Funksionet:

Nga viti i ndërtimit e deri më sot, Hamami i Gazi Mehmed Pashës ka pasur funksione të ndryshme.

- **Vitet 1563/4 – 1914** – ka funksionuar si banjë publike me pjesë të ndara për shfrytëzim nga meshkujt dhe femrat.
- **1914**– Pjesa për femra është mbyllur për shfrytëzim si hamam, përderisa pjesa e meshkujve ka vazhduar së funksionuari.
- **1926 - 1944** - Pjesa për meshkuj shfrytëzohet si banjë publike dhe vend për zbavitje.
- **1946 – 1961** – Pjesa e femrave është shfrytëzuar si hapësirë për punëtorinë e prodhimit të djathit, e më pas si depo.
- **1954** – Hamami është shpallur monument nën mbrojtje të shtetit, që ka mundësuar realizimin e punëve restauruese dhe mirëmbajtëse.
- **1960 - 1991** - Janë kryer punët e ndryshme restauruese - konservuese dhe rregullimi i oborrit. me ç'rast nuk ka pasur ndonjë aktivitet kulturor ose tjetër.
- **1991 – 1999** – Hamami është lënë në mëshirë të kohës, pa ndonjë funksion apo mirëmbajtje. Ambientet e hamamit shfrytëzohej si depo e materialit ndërtimor të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës.

- **2001 – 2003** - Pastrimi i hamamit me disa riparime të vogla dhe vazhdimi i menaxhimit nga ana e Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturor në Prizren.
- **2001 – 2013** – Organizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike në hapësirat e Hamamit.

Transformimet – Ndërhyrjet konservuese:

Nga viti i ndërtimit e deri më sot, ndërtesa ka pësuar ndërhyrje të numërta konservuese:

- Viti 1833 – restaurimi i ndërtesës nga ana e vëllezërve Mahmud dhe Emin Pashë Rrotullaj (Rrotllaj).
- Viti 1898 - Hamami i nënshtrohet një restaurimi tjetër.
- Viti 1914-1926 - Riparimet e ndryshme në pullaz, ndarja fizike e nën-dyshemesë (*hypocaustit*) dhe zhvendosja e oxhakut në anën lindore të hamamit.
- Viti 1926 - Adaptimi i pjesës për meshkuj të hamamit për ri-shfrytëzim. Vendosja e tubave metalike të ujës-jellësit, ndërtimi i galerisë dhe adaptimet tjera.
- Viti 1946 - Adaptimi i pjesës për femra në ambient për tubimin dhe përpunimin e qumështit. Është bërë mbushja e pjesës nën-dyshemesë (*hypocaustit*) dhe betonimi i dyshemesë dhe ulëseve (*sofave*).
- Viti 1960 - Fillimi i punimeve restauruese dhe revitalizuese të hamamit e cila nuk është përfunduar asnjëherë.
- Deri në vitet 1964 - Hamami ka qenë i rrethuar me lokale me ç'rast bëhet rrënimi i lokaleve dhe vazhdojnë punët restauruese-konservuese së bashku me rregullimin e oborrit dhe rrugës.
- Në vitet 1974-1976 – Veshja e pullazit me pllaka plumbi.
- Në vitet 1980-1986 - rregullimi i oborrit (shtruarja me pllaka të gurit, gjelbërimi dhe rregullimi i jazit) dhe ndërtimi i murit rrethues të oborrit.
- Viti 2000 - Pastrimi dhe largimi i eshtrave nga brendia e hamamit.
- Viti 2001 - Vendosja e rjetit elektrik dhe ndriçimit në enterier për organizim të ekspozitave, dhe vendosja e tetë dritareve në tambure, donacion nga KFOR-i.
- Viti 2003 - Riparimi dhe ri-vendosja e tjegullave të dëmtuara në trompa. Rivendosja e gjashtë dritareve të drurit në tambure të pjesës së ftohtë (gardërobës) të hamamit.
- Viti 2011 – Hartimi i planit të restaurimit dhe rehabilitimit të hamamit.
- Viti 2013-2014 - Fillimi i punimeve restauruese (faza e parë) që përfshin ndërhyrjet në pjesën e pullazit. Projekti i financuar nga UNESCO.

Fazat kryesore ndërtimore:

- **Faza fillestare ndërtimore** është koha e ndërtimit të hamamit që është diku në mes të shek XVI. Në mungesë të dëshmisë materiale ose shkrimore nuk dihet saktë data e ndërtimit.
- **Faza e dytë:** Deri në shek XIX nuk kemi ndonjë dëshmi për ndonjë intervenim, edhe pse duhet të kishte për arsye teknike dhe kohore pa përjashtuar edhe ngjarjet historike sidomos ato që kanë të bëjnë me luftërat Osmane-Austriake.
- **Faza e tretë:** Faza tjetër e rindërtimit dhe restaurimit është bërë në vitin 1833 nga na e vëllezërve Rrotllaj (Mahmud dhe Emin Pasha). Nuk kemi ndonjë dokument ku përshkruhet volumni (sasia) i punëve të bëra, por bazuar në teknikën ndërtimore dhe materialet e përdorura mund të konstatohet që ndërhyrjet kanë qenë me përmasa mjaft të mëdha në gjithë strukturën ndërtimore.

- **Faza e katërt:** Në vitin 1898, hamami nënshtrohet edhe një riparimi por nuk dihet volumin e punëve të bëra. Bazuar në gjendjen faktike të hamamit besojmë se në këtë kohë është lënë jashtë funksionit pjesa për femra e hamamit me ç'rast është bërë ndarja fizike e nën-dyshemesë (*hypocausti*), është zhvendosur vendi i oxhakut dhe pullazi është mbuluar me rrasa guri.
- **Faza e pestë:** Diku mes dy Luftërave Botërore (rreth vitit 1926) bëhet edhe një intervenim në pjesën për meshkuj të hamamit. Në pullaz janë bërë disa punë adaptuese si mbushja e sipërfaqes mes kubeve dhe qemerëve me ç'rast janë mbyllur një numër i konsiderueshëm i hapjeve për ndriçim. Pullazi është veshur me llaç gëlqeror dhe çimento. Janë zëvendësuar tubat e ujit prej qeramike me tubat metalike. Është (ri)ndërtuar galeria në pjesën e ftohtë të hamamit (gardërobës), është ngjyrosur enterieri dhe disa punë tjera adaptuese.
- **Faza e gjashtë:** Duke filluar nga viti 1960 e deri në vitet 1990 janë bërë punime restauruese me qëllim të adaptimit të ambienteve të hamamit në muze ose galeri, por punimet nuk janë përfunduar asnjëherë.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

- *Atributet dhe vlerat që paraqet asemi, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 4, Rreg. Nr.05, 2008, MKRS.*
- *Analiza analoge e aseteve të njëjta në nivelin lokal, shtetëror dhe më gjerë.*
- *Autenticiteti/Integriteti*

Deklarata e rëndësisë

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është bartës i vlerave specifike arkitekturale, historike, kulturore dhe shoqërore për qytetin dhe regjionin. Si një monument nga periudha e hershme Osmane, ai është njëri prej hamameve më të rëndësishme në Evropën Jug-lindore. Specifika kryesore e hamamit është ndërthurja e arkitekturës dhe kulturës Osmane me atë lokale.

I ndërtuar në qendër të qytetit, Hamami për shekuj me radhë ka qenë pjesë e pandashme e jetës së qytetarëve të Prizrenit dhe është shndërruar në simbol shpirtëror dhe kulturore për qytetin dhe regjionin.

Vlerat:

Vlerat historike: Hamami i Gazi Mehmed Pashës me vjetërsinë dhe origjinalitetin e ruajtur deri në ditët e sotme, paraqet një dëshmi të zhvillimeve kulturore dhe arkitekturore gjatë shekullit XVI dhe XIX në Prizren. Po ashtu është dëshmi e mënyrës së re të jetesës dhe organizimit shoqëror krahas periudhës pararendëse (para Osmane). Edhe ndërtuesi i hamamit Gazi Mehmed Pasha ka qenë një personalitet i rëndësishëm që ka lënë gjurmë të rëndësishme në këto treva në mesin e shekullit XVI. Gazi Mehmed Pasha përpos pjesëmarrjes në beteja të ndryshme ka ndërtuar objekte të ndryshme si *vakëf* – bamirësi anëmbanë perandorisë Osmane.

Vlerat artistike: Hamami i Prizrenit është njëra prej ndërtesave publike më të dalluara që datojnë nga periudha Osmane. Posedon vlera estetike që përfshin kombinimin e volumeve në eksterier, teknikat e ndërtimit dhe elemente origjinale të ruajtura në enterier. Vlerat e lartpërmendura e shndërrojnë hamamin në njërin prej pikave kryesore të referimit në peizazhin kulturor dhe vizual të Prizrenit.

Vlerat shkencore: Hamami paraqet një dëshmi faktike për të zhvilluar studime shkencore rreth sistemit të ndërtimit dhe stabilitetit të strukturës ndaj tërmeteve; Një rast studimi për sistemin ujësjellës dhe të kanalizimit gjatë shek. 16; Studim për sistemimin dhe shpërndarjen e ujit të ftohtë dhe të nxehtë në pika të ndryshme të hamamit me rënie të lirë; Studim për materialet ndërtimore të qëndrueshme ndaj ndikimeve të ujit dhe motit; Studim për efikasitetin termik brenda ndërtesës, mënyra e ngrohjes së ujit dhe ambienteve të hamamit në masë të caktuar sipas nevojës.

Krahas hulumtimeve teknike shkencore, vetë ndërtesa paraqet një dëshmi për studime dhe hulumtime në fushën e arkeologjisë, kulturës, arkitekturës dhe sociologjisë.

Vlerat shoqërore: Krahas vlerave historike, teknike dhe estetike, Hamami ka vlerë të madhe shoqërore. Ai përfaqëson vendin ku është mirëmbajtur higjiena personale. Hamami ka qenë gjenerues material dhe ishte si "donator" i institucioneve jo profitabile e sidomos kompleksit të Mehmed Pashës. Krahas funksionit shërbyes, Hamami ka qenë një vend takim për njerëzit. Edhe pse tani ka humbur funksionin origjinal, Hamami vazhdon të jetë një vend takim dhe pikë referuese për komunitetin lokal të Prizrenit.

Vlerat shpirtërore: Hamami është simbol i identitetit kulturor dhe fetar; paraqet njërën nga simbolet e identitetit Osman të ndërlidhur me identitetin lokal të Prizreni gjatë shek. 16. Kultura e larjes në hamame ishte bërë pjesë e jetesës së popullatës së Prizrenit dhe më gjërë. Konsiderohet si njëri prej monumenteve kryesore që e identifikojnë qytetin.

Rariteti: Hamami i Gazi Mehmed Pashës është njëra nga gjashtë hamamet e Kosovës respektivisht njëra nga katër hamamet dysh (çifte hamam). Për nga madhësia dhe origjinaliteti është i vetmi i ruajtur në Kosovë dhe njëra nga 3-4 hamamet e rajonit.

Analiza analoge e aseteve të njëjta në nivelin lokal, shtetëror dhe më gjerë

- Për nga madhësia dhe volumi hamami i Gazi Mehmed Pashës mund të krahasohet me hamamet e Kosovës siç janë:

Hamami i Shemsudin Ahmed beut në Prizren (Muzeu Arkeologjik me sahat kullë), hamami i Sulltan Mehmed Fatihut në Prishtinë dhe (pjesërisht, deri-diku) me hamamin e Haxhi Beut në Pejë.

Në rajon mund të krahasohet me hamamin e Daut Pashës në Shkup, hamamin në Manastir (Maqedoni), hamamin e Husref Beut në Sarajevë, hamamin e Isa Beut në Novi Pazar, hamamin e Sulltan Murad II në Selanik, etj.

Për nga planimetria nuk kemi ndonjë hamam që ka planimetri identike me hamamin e Gazi Mehmed Pashës, por si tipologji bazuar në pjesën e ngrohtë (*caldariumi*), pjesa për meshkuj që ka trajtën e kryqit të brendashkruar (tipi "a" sipas S. Eyice) ngjason me:

Hamamin e Haxhi Beut në Pejë, hamamin e Daut Pashës në Shkup, hamamin e Sulltan Murad II në Selanik, etj.

Autenticiteti/Integriteti

Hamami i Gazi Mehmed Pashës ka të ruajtur të gjitha fazat e ndërtimit (diku më pak e diku më shumë). Kështu nga faza fillestare (mesi i shek XVI) është ruajtur një pjesë mjaft e madhe të strukturës ndërtimore të nën-dyshemesë (hypocaustit), disa pjesë të mureve të brendshme dhe të jashtme si dhe të pullazit.

Nga faza e restaurimit të bërë nga vëllezërit Rrotllaj në shek. XIX (1833), është ruajtur thua se në tërësi struktura ndërtimore, derisa ruhen edhe ndërhyrjet e bëra mes dy Luftërave Botërore si dhe ato të viteve 1960/90.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- *Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes të elementeve origjinale të asetit*
- *Përshkrimi i gjendjes teknike*
- *Faktorët ndikues ndaj asetit, presionet e zhvillimit bashkëkohor, adaptimet, transformimet, demolimet, ndërtimet e reja, agrokultura, veprimet ilegale, ndotja, fatkeqësitë natyrore, aksidentale, etj.*

Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes së elementeve origjinale

Përveç strukturës ndërtimore që janë ruajtur nga gjitha fazat ndërtimore dhe meremetuese (restauruese), hamami ka të ruajtur edhe elementet origjinale të kohës. Këtu mund të përmendim:

- Mbishkrimin e renovimit të vitit 1833;
- Tubacionet e ujit prej qeramike;
- Vaska (*kurna*)t e ujit;
- Kapakun metalik për ngrohjen e ujit të depos së ujit (*hazne*);
- Shatërvanin në ambientin e gardërobës të pjesën për meshkuj;
- Kafe-oxhakun;
- Ulëset (sofat) dhe
- Platformën për masazh.

Përshkrimi i gjendjes teknike: Gjendja & Konservimi i lokalitetit

Ndërtesa e Hamamit është në gjendje të rëndë fizike dhe në rrezik për dëmtim të mëtejme. Mungesa e riparimeve dhe mirëmbajtjes së kulmit, me ç'rast një pjesë e madhe e mbulesës është larguar apo vjedhur, ka shkaktuar dëme të vazhdueshme në strukturën e ndërtesës, ku lagështia dhe rritja e bimësisë kanë bërë efektin e tyre.

Në vitin 2010, është hartuar Plani i Restaurimit nga ekipi i ekspertëve lokal nën mbikëqyrjen e ekspertës nga Turqia, Prof. Dr. Zeynep Ahunbay.

Faza e parë e restaurimit është financuar nga qeveria Turke nëpërmjet UNESCO-s, dega në Venedik përmes Zyrës në Sarajevë (*UNESCO Venice Office – Antenna Office Sarajevo*). Faza e parë ka përfshirë ndërhyrjet urgjente në Hamam në mënyrë që të sigurohet ndërtesa nga dëmtimet e mëtejme. Punët restauruese kanë filluar në vitin 2013 dhe janë ende në vazhdim.

Punët e kryera gjatë kësaj faze janë si në vijim:

- Largimi i bimësisë, shtresave të betonit dhe mbushjeve tjera nga pullazi që janë bërë gjatë intervenimeve jo adekuate gjatë viteve 1960ta;
- Rikonstruimi i pjesshëm i kupolave të dëmtuara dhe të rrënuara në pjesë për femra të hamamit;
- Restaurimi dhe riparimi i plasaritjeve dhe dëmtimeve tjera strukturale në kupola dhe gëmerë;
- Vendosja e qeramidheve të ngjashme me ato origjinale në kupolat që mbulojnë pjesën e ftohtë të hamamit (gardërobës - *apodyteriumi*);

- Vendosja e llaçit tradicional dhe pllakave të plumbit mbi kupolat dhe qemerë që mbulojnë pjesën e nxehtë dhe atë teknike;
- Restaurimi i hapjeve të gjashtë dritareve në tamburet e pjesës pjesën e ftohtë të hamamit dhe vendosja e dritareve të punuara enkas për to.
- Pastrimi i fugave, riparimi i dëmtimeve dhe mbushja e fugave në tamburet pjesës pjesën e ftohtë të hamamit

Për shkak të harxhimeve të paparashikueshme, sikurse rekonstruimi i katër kupolave mbi pjesën e ngrohtë dhe qemerit mbi pjesën e vaktë të pjesës për femra, fondi i siguruar nuk ka mjaftuar për përmbylljen e fazës së parë të restaurimit.

Krahas përfundimit të fazës së parë të restaurimit, nevojiten fonde shtesë për të siguruar ruajtjen dhe konsolidimin e strukturës, të pasuar me adaptimin për të akomoduar funksionet e reja të propozuara.

Faktorët ndikues ndaj asetit

Faktorët natyror – Faktorët kryesorë që dëmtojnë monumentin janë shiu dhe lagështia, të cilët kanë depërtuar në ndërtesë. Ndërtesa është dëmtuar edhe nga vegjetacioni i cili ka mbuluar sipërfaqen e mureve dhe pullazin. Këto rreziqe natyrore janë të konsiderueshme.

Faktori njeri - Rritja e numrit të popullsisë dhe shfrytëzimet ilegale të zonës afër Hamamit dëmton dhe degradon integritetin ambientel të monumentit. Mungon mirëmbajtja, shenjat për orientim të vizitorëve dhe materiali informues.

Trafiku – Lokacioni i hamamit është rrethuar nga tre anët me rrugë dhe rrugica ku qarkullojnë një numër i konsiderueshëm i automjeteve dhe makinerive tjera të cilët nxjerrin gazra si dhe shkaktojnë dridhje (vibrime shkatërruese) që dëmtojnë monumentin.

5. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershëm mbi statusin ligjor të asetit.*
- **Shtojcë 1**, A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, në formë të shtypur dhe dixhitale.
- **Shtojca 2**, Planet e situacionit të asetit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese, P=1:200 dhe P=1:500, në formë të shtypur dhe dixhitale.
- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zonës rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelat, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.*
- **Shtojcë 3:** Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.
- **Shtojcë 4:** Plani i Menaxhimit

6. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë Prizren

Hartuesit e formularit: Jusuf Xhibo - ida. & MSc. Arkeologji
 Nora Arapi Krasniqi - Bark. MSc. Konservim

Personi i autorizuar:

Adresa dhe kontakti:

Data: .../.../.....

Nënshkrimi:

Fotografitë e vjetra



Hamami i Gazi Mehmed Pashës në vitin 1913 (nga A. Khan)



Hamami i Gazi Mehmed Pashës në vitin ~1963



Hamami i Gazi Mehmed Pashës në vitin ~1963



Hamami i Gazi Mehmed Pashës në vitin ~1967 (nga M. Kiel)



Hamami i Gazi Mehmed Pashës në vitin ~1966

Fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit



Pamje e Hamamit nga lart



Pamje jugore e hamamit



Pamje veriore e kubeve



Pullazi dhe pjesa e ftohtë e Hamamit



Zona e ftohtë pjesa për meshkuj (majtas) dhe për femra (djathtas)



Zona e vaktë pjesa për meshkuj (majtas) dhe për femra (djathtas)



Zona e nxehtë pjesa për meshkuj (majtas) dhe për femra (djathtas)



Nëndyshemeja – hypocausti



Depoja e ujit



Fontana në zonën e ftohtë për meshkuj



Hyrja për meshkuj dhe mbishkrimi i renovimit të vitit 1833